



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 865/2 prot

Datë 25.04.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E**  
**OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT**  
**NGRIHEN PRETENDIME**

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Vibtis” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-59068-02-15-2023, me objekt: “Blerje koshash për mbetjet urbane”, me fond limit 8,330,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Sark” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Ankimues:**

“Luar Bros” SHPK  
*Rruga “Nasi Pavllo”, pall 15/1, Shkalla 1, Apartamenti nr. 1, Tiranë*

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Himarë  
*Spile, Himarë*

**Subjekte të Interesuara:**

“Vibtis” SHPK  
*Bulevardi “Deshmoret e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla nr 2, Kati 8/4, Tirane*

“Alko Impex Construction” SHPK

*Rruga "Reshit Petrela", Kompleksi Usluga, kati i 8, prane stacionit te trenit, Tirane*

*"Sark" SHPK*

*Lagjja 8 Shkurti, Rruga Skenderbej, Fier, Rajoni nr 3, Perball supermarket Lalaj, Fier*

Në datën 24.04.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr.865 prot.,e operatorit ekonomik "Luar Bros" SHPK, për procedurën e prokurimit "E hapur, e thjeshtuar", me Nr. REF-59068-02-15-2023, me objekt: "Blerje koshash për mbetjet urbane", me fond limit 8,330,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë "Vibtis" SHPK, "Alko Impex Construction" SHPK dhe "Sark" SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma "c" të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", ku parashikohet se: *"Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime."*

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik "Luar Bros" SHPK me anë të ankesës me nr. 865 protokolli, datë 24.04.2023, pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë "Vibtis" SHPK, "Alko Impex Construction" SHPK dhe "Sark" SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorëve ekonomikë "Vibtis" SHPK, "Alko Impex Construction" SHPK dhe "Sark" SHPK,, të kriterëve si më poshtë:

## **Shtojca 7**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

#### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

*Ofertuesi deklaron se:*

*a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

Gjithashtu operatori ekonomik ankimues “Luar Bros” SHPK pretendon se per sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të kryente verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatorët ekonomikë “Vibtis” SHPK, “Alko Impex Construction” SHPK dhe “Sark” SHPK sipas shtojcës 8 pasi operatorët ekonomikë kanë dhënë deklaram të pa saktë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit i cili përbën shkak për përjashtim nga prokurimet publike sipas përcaktimeve të nenit 26 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar ku parashikohet se;

\*Cdo vetëdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtim të tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet siaps parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.

.....

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.3** Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi, për të gjitha zërat objekt prokurimi në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë mallrat që do të ofrohen.

-Në ankesë ngrihen pretendime edhe për mospërbushje nga ana e operatorëve ekonomikë “Vibtis” SHPK, “Alko Impex Construction” SHPK dhe “Sark” SHPK,, të specifikimeve teknike si më poshtë:

#### **1. Kontenier plastik për mbetje urbane me kapacitet 1100 Litra.**

- rezistent ndaj temperaturave të ulta (deri në  $-30^{\circ}\text{C}$ ) dhe të larta (deri në  $+80^{\circ}\text{C}$ ).
- Peshë e kontenierit duhet të jetë 46 kg.
- Permasat e kontenierit: Gjatesia (L-length): 1074 mm; Gjerësia (W-width): 1370 mm; Lartësia (H-height): 1355 mm dhe gjerësia aksiale 480 mm
- Trupi i kontenierit do të jetë 100 % material plastik (HDPE), 100 % i ricikluar.
- Kontenieri të jetë në gjendje të durojë kushtet klimaterike të ndryshme, për të gjithë përbërësit, dhe temperatura nga  $-30^{\circ}\text{C}$  deri  $+80^{\circ}\text{C}$ .
- Kontenieri të jetë sipas standarteve EN 840-2-5-6 ose ekuivalent.
- Kontenieri të jetë në përputhje me standartin RAL GZ951/1 dhe AfPS GS 2019.
- Kontenieri të jetë konform direktives 2000/14/EC dhe në dokumentacionin teknik shoqerues të përmbajë markimin CE.
- Prodhuar nga prodhues të certifikuar sipas standartit ISO 9001 : 2015 ose ekuivalent.

#### **2. Kontenier plastik për mbetje urbane me kapacitet 240 Litra**

- Peshë boshë e kontenierit: 12-13 kg
- Peshë totale me ngarkesë: jo më pak 110 kg
- Peshë mbajtëse e lejuar: jo më pak 96 kg

- *Permasat e kontenierit*  
Gjatesia duke perfshire dorezen e terheqjes: jo me pak se 1080 mm;,  
Gjatesia e dorezes se terheqjes: jo me pak se 410 mm.  
Gjeresia aksiale duke perfshire rrotat: jo me pak se 570 mm;  
Lartesia duke perfshire kapakun: jo me e madhe se 1090 mm.  
Lartesia pa kapakun: jo me pak se 1000 mm
- *Kontenieri te jete rezistente ndaj temperaturave te larta (deri ne +80 grad Celsius) dhe temperaturave te ulta (deri ne – 30 grade Celsius).*
- *Koshi te jete i certifikuar sipas standartit: EN 840-1.*
- *Niveli i zhurmave nuk duhet te jete me i larte se 95 decibel (dB).*
- *Kontenieri te jete ne perputhje me standartin RAL GZ951/1.*
- *Kontenieri te jete konform direktives 2000/14/EC dhe ne dokumentacionin teknik shoqerues te permbaje markimin CE.*
- *Prodhuar nga prodhues te certifikuar sipas standartit ISO 9001 : 2015 ose ekuivalent.*

### **3. Kontenier plastik per mbetje urbane me kapacitet 120 Litra**

- *Pesha boshe e kontenierit: 9-10 kg*
- *Permasat e kontenierit:*  
Gjatesia duke perfshire dorezen e terheqjes: jo me pak se 550 mm;,  
Gjatesia e dorezes se terheqjes: jo me pak se 370 mm.  
Gjeresia aksiale duke perfshire rrotat: jo me pak se 480 mm.  
Lartesia duke perfshire kapakun: jo me e madhe se 965 mm.  
Lartesia pa kapakun: jo me pak se 900 mm.
- *Pesha totale me ngarkese: jo me pak 60 kg*
- *Pesha mbajttese e lejuar: jo me pak 48 kg*
- *Kontenieri te jete rezistente ndaj temperaturave te larta (deri ne +80 grad Celsius) dhe temperaturave te ulta (deri ne – 30 grade Celsius).*
- *Koshi te jete i certifikuar sipas standartit: EN 840-1.*
- *Niveli i zhurmave nuk duhet te jete me i larte se 95 decibel (dB).*
- *Kontenieri te jete ne perputhje me standartin RAL GZ951/1.*
- *Kontenieri te jete konform direktives 2000/14/EC dhe ne dokumentacionin teknik shoqerues te permbaje markimin CE.*
- *Prodhuar nga prodhues te certifikuar sipas standartit ISO 9001 : 2015 ose ekuivalent.*

### **4. Kontenier metalik per mbetje urbane me kapacitet 30 Litra.**

- *Permasat e kontenierit metalik:*
- *Lartesia e kontenierit: 480 – 500 mm.*
- *Spresori i llamarines te kontenierit: jo me pak se 1 mm.*
- *Diametri i kontenierit: 300 - 320 mm.*
- *Mbajtesia e cigareve duhet te kete keto permasa:*  
Gjeresia: 90 mm  
Gjatesia 90 mm  
Lartesia 190 mm.
- *Kontenieri te jete në gjendje të durojë kushtet klimaterike te ndryshme, për të gjithë përbërsit,dhe temperatura nga -20°C deri +50°C.*
- *Përbëhet nga një fllanxhë e formës së veçantë dhe ka tre vrima për fiksimin e hekurit në tokë me vida dhe vrima të seksionit kryq të përshtatshëm. Diametri i fllanxhës është 280 mm dhe trashësia e saj është rreth 2 mm.*
- *Fllanxha bashkohet me një tub çeliku Ø 60, 2 mm i trashë dhe 90 cm i larte.*
- *Prodhuar nga prodhues te certifikuar sipas standartit ISO 9001 : 2015 ose ekuivalent.*

**5. Kontenier metalik per mbetje urbane me kapacitet 50 litra**

- *Pesha e koshit: perafersisht 4 kg.*
- *Dimesionet e kontenierit: 430x340x740*
- *Prodhuar nga prodhues te certifikuar sipas standartit ISO 9001 : 2015 ose ekuivalent.*
- *Peshes së kontenierit 46 kg*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 25.04.2023.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**